VENDIM
Nr. 145, datë 28.8.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E "KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME TË KONTRATËS TIP TË FURNIZIMIT ME GAZ NATYROR, PËR KLIENTËT FUNDORË QË PËRFITOJNË NGA SHËRBIMI PUBLIK I FURNIZIMIT"

Në mbështetje të nenit 16 dhe neneve 75, 89, 92, 93 dhe 94, të ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, si dhe nenit 26, të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.8.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 98/4 prot., datë 26.8.2020, e përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, mbi fillimin e procedurës për miratimin e draftit që parashikon kushtet e përgjithshme të kontratës tip të furnizimit me gaz natyror për klientët fundor që përfitojnë nga shërbimi publik i furnizimit,

konstatoi:

- Në përmbushje të detyrimeve që cakton ligji nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", parashikuar në nenin 16, pika 10, neneve 92, 93, pika 1, ERE miraton kushtet e përgjithshme të furnizimit për klientët fundorë, duke përfshirë këtu edhe hartimin në mënyrë transparente të të drejtave dhe detyrimeve kontraktuale të përgjithshme, në shërbimin e furnizimit të ofruar nga të licencuarit, në aktivitetin e furnizimit publik në sektorin e gazit natyror.
- Dispozitat e kontratës së furnizimit me gaz natyror duhet të jenë të drejta, proporcionale, të qarta dhe të kuptueshme, dhe duhet të aplikohen në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese.
- Në këtë rregullore përcaktohet se kontratat e furnizimit me gaz natyror nuk duhet të kenë pengesa në ushtrimin e të drejtave të klientit fundorë dhe nuk duhet të paraqesin metoda të padrejta ose çorientuese të shitjes, matjes, faturimit dhe/ose pagesës.
- Kontratat e furnizimit me gaz natyror nuk duhet të përmbajnë dispozita që mund të parandalojnë ose pengojnë klientin nga ndërprerja e njëanshme e kontratës, sipas afateve dhe kushteve të vendosura në këto rregulla dhe/ose ndryshimi pa pagesë i furnizuesit, sipas rregullave të ndryshimit të furnizuesit, të miratuara nga ERE.
- Drafti me kushtet e përgjithshme të kontratës tip të furnizimit me gaz natyror për klientin fundor që përfiton nga shërbimi publik i furnizimit, është hartuar në mbështetje të neneve 75, 89, 92, 93, 94, të ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, gjithashtu dhe ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorëve", të ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar.
- Drafti i kushteve të përgjithshme të kontratës tip të furnizimit me gaz natyror për klientët fundorë që përfitojnë nga shërbimi publik i furnizimit, do të konsultohet me palët e interesit, përpara miratimit.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e kushteve të përgjithshme të kontratës tip të furnizimit me gaz natyror, për klientët fundorë që përfitojnë nga shërbimi publik i furnizimit.
2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti